

FJALA E DEPUTETES ERMONELA FELAJ

E ENJTE 28 PRILL 2022

Do të përpiqem të flas në mënyrë të përmbledhur dhe të mos i shpenzoj 10 minuta për këtë diskutim, por sidoqoftë dita e punës për ne është e rëndësishme dhe ajo duhet të shprehet si me pjesëmarrje, ashtu edhe me përfshirje. Konventa e Këshillit të Europës “Për aksesin në dokumentet zyrtare” është një konventë e nënshkruar në vitin 2009, por ka hyrë në fuqi vetëm më 1 dhjetor të vitit 2020, pasi ishte kusht i parashikuar në përmbajtjen e konventës, që konventa të hynte në fuqi pasi të ishte ratifikuar prej jo më pak se 10 vende. Aktualisht, bilanci i nënshkrimit dhe i ratifikimit të kësaj konvente, që janë dy momente të ndryshme, paraqitet i tillë: konventa është nënshkruar nga 20 vende, ndërkohë që është ratifikuar nga 11 vende dhe jo të gjitha këto vende janë domosdoshmërisht vende të BE-së.

Në momentin që qeveria shqiptare propozon në Kuvendin e Shqipërisë ratifikimin e kësaj konvente, sigurisht që kjo është diçka për t’u vlerësuar dhe jo vetëm, por edhe për t’u kuptuar drejt, për t’u përcjellë siç duhet, si dhe për t’u promovuar siç duhet. Ne jemi ligjvënës dhe e kemi detyrim që t’i kuptojmë ligjet siç duhet, por edhe t’ua përcjellim qytetarëve siç duhet. Dua të bëj një shikim paralel të konventës europiane “Për aksesin në dokumentet zyrtare” dhe konventës europiane “Për lirinë dhe të drejtat e njeriut”. Besoj se në këtë sallë të gjithë e dinë që konventa europiane “Për lirinë dhe të drejtat e njeriut” vendos garanci minimale të mbrojtjes së lirisë dhe të drejtave të njeriut. Asnjë vend nuk mund të shkojë poshtë këtyre garancive që vendos kjo konventë, përkundrazi, mund të lejojë një hapësirë më të gjerë të lirive dhe të drejtave të njeriut.

Në të njëjtin shikim është edhe konventa europiane “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, sepse ajo vendos kufirin e poshtëm, përtej të cilit nuk mund të shkojnë autoritetet publike të vendeve që e kanë ratifikuar këtë konventë, pra janë të detyruara që të mund t’i njohë disa standarde që i vendos konventa, si standarde minimum, në lidhje me qasjen në dokumentet zyrtare. Nga këtu kuptohet qartë se tashmë është detyrim i të gjitha autoriteteve tona publike që standardet që ofron konventa për realizimin e aksesit në dokumentet zyrtare duhet të zbatohen detyrimisht. Këtë e thotë edhe Kushtetuta. Në fakt, unë ju ftoj të lexoni dy nene të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 116 dhe 122 të saj, të cilët parashikojnë qartësisht se të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare që ratifikojmë kanë epërsi mbi ligjet e brendshme. Në momentin që ratifikohen, ato bëhen pjesë e sistemit juridik të brendshëm dhe vetëzbatohen.

Në rast se ligjet e vendit vijnë në kundërshtim me atë çka parashikon konventa, sigurisht që do të zbatohet konventa. Ndaj është e rëndësishme ta vëmë theksin në këto pika për të kuptuar që më pas do të na duhet monitorimi, që të sigurojmë se standardet e konventës, për të cilat po biem dakord sot, të mund të respektohen nga të gjitha autoritetet publike sa u takon dokumenteve zyrtare që ato krijojnë ose prodhojnë. Për çfarë vlen ushtrimi i kësaj të drejte? Kuptohet qartë se kjo e ndihmon publikun, që, së pari, të njihet me të gjithë larminë e dokumentacioneve zyrtare dhe, nga ana tjetër, publiku, në mënyrë objektive, të kuptojë gjendjen e shoqërisë dhe veprimtarinë që ushtrojnë autoritetet publike.

Gjithashtu, kjo mundësi që po i japim publikut, në standardet e konventës, do të thotë edhe përgjegjësi për autoritetet publike, së pari, sepse ato do të detyrohen t'i japin dokumentet, nuk mund t'i fshehin dokumentet apo të nxjerrin justifikime për mosvënien në dispozicion të tyre. Lidhur me këtë, në cilat dokumente do të jetë e drejta për akses? Konventa parashikon një përkufizim shumë të gjerë për dokumentet zyrtare, të cilat nuk janë thjesht letra, që përmbajnë një informacion të shkruar, por dokument zyrtar, sipas konventës, konsiderohet i gjithë informacioni i regjistruar në çfarëdolloj forme: teksti i shkruar, informacioni i regjistruar në një kasetë audio-vizuale, fotografi, e-mail, informacion i ruajtur në formë elektronike, siç janë bazat e të dhënave elektronike që hartohen, merren dhe ndahen nga autoritetet publike. Kjo ishte pika e parë që është e rëndësishme ta dimë.

E dyta, të drejtën e qasjes në dokumente do ta kenë edhe personat fizikë, publikë dhe ata juridikë. Këtu nuk bëhet asnjë lloj diskriminimi, madje edhe shtetasit e huaj, sipas konventës, kanë të drejtën të kenë akses në dokumentet zyrtare. Kufizimet e kësaj të drejte, si për çdo të drejtë tjetër, që nuk është absolute, lidhen me kushte dhe kritere të caktuara, të cilat i kemi shprehur qartësisht edhe në Kushtetutën tonë. Kërkuesi nuk detyrohet të japë arsye konkrete se për çfarë i duhet dokumenti zyrtar, çka do të thotë se autoriteti publik nuk mund të përdorë si justifikim mosdhënien e dokumentit faktin që nuk ka dhënë arsye pse i duhet ky dokument. Autoriteti publik, madje, duhet të bëjë përpjekje që, edhe në rastin që kërkuesi nuk e identifikon saktësisht titullin ose emërtimin e dokumentit që kërkon, të përpiqet ta gjejë dhe ta vërë në dispozicion.

Sa është koha në të cilën duhet t'ua vendosë në dispozicion? Sa më e shkurtër e mundshme. A ka pagesë për marrjen ose vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare? Normalisht, nuk kalohet kostoja e prodhimit të tyre. Të mos harrojmë që pak kohë më parë ne kemi miratuar ligjin "Për të dhënat publike që krijojnë organet publike dhe sipërmarrjet publike" dhe në masën më të madhe ato të dhëna do të mund të aksesohen free, përveç një kategorie të caktuar, kryesisht në rastet kur kërkohet që ato të ripërdoren, sigurisht do të ketë një tarifë, e cila nuk e pamundëson, ose e vë në dyshim njohjen e kësaj

të drejte. Nuk i përmenda më kot këto standarde, sepse thashë që në krye të herës, e para, nuk është e thjeshtë të mbërrish deri te këto standarde, sepse kërkohen përgjegjësi dhe maturi. Pak më parë këtu u bë një diskutim: a keni këllqe ju, të majtët, për të bërë këtë apo atë gjë? Po, ne kemi këllqe, kemi edhe moral, sepse jemi konsistentë në gjëra dhe, po të vijmë te diskutimi se kush ka ndërtuar apo ka punuar më shumë për transparencën, ju siguroj se peshorja shkon nga e majta, nuk shkon nga e djathta.

Ne që në mandatin tonë të parë punuam për nënshkrimin elektronik dhe vulën elektronike dhe besoj se ishte një qasje e zgjuar, sepse komunikimi sot nuk ndodh aq shumë me letra fizike sesa kërkohet të ndodhë online dhe ne jemi përshtatur shumë herët. Që prej datës 1 maj kjo na mundësoi neve jo thjesht t'u japim qytetarëve një shumicë shërbimesh online, në mënyrë virtuale, por, po sjell një shembull, të gjitha dokumentet që janë në zyrat e sigurimeve shoqërore për më tepër se 600 mijë pensionistë që ka Shqipëria ata do të mund t'i marrin të gjitha dokumentet që disponon kjo zyrë, e cila e ka shtrirjen e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe mund t'i aksesojnë online. Pra, kemi punuar në drejtime të ndryshme, direkte dhe indirekte, për të siguruar pikërisht transparencën që, në gjykimin tim, është një përmasë demokracie, dhe kjo është ajo që na dallon.

Unë, patjetër, nuk kam asnjë dyshim që edhe deputetët e pakicës e kanë votuar këtë konventë, se nuk kanë arsye për të mos e votuar dhe do të ishte në turpin e tyre të mos e votonin një konventë europiane, por ajo që realisht vë në dyshim vullnetin e mirë të tyre, për sa kohë që e kanë miratuar këtë konventë, është pikërisht diskutimi që vjen më pas dhe ai që lidhet me të dhënat, të cilat u bënë publike vitin e shkuar. Për këtë të fundit dua të them se ka një hetim penal, i cili është bërë publik dhe ka treguar qartësisht që ata, që nxorën të dhënat e pagave dhe të dhënat që lidhen me automjetet, ishin thjesht përdorues të sistemeve, të cilët për arsye dhe qëllime totalisht private i shitën këto të dhëna dhe, natyrisht, do të marrin ndëshkimin. Zgjidhja për këtë u gjet në kohë reale.

Ndërkohë, lidhur me çështjen tjetër, për të cilën ju na akuzoni, për sistemin e patronazhistëve, unë nuk po shkoj më larg për t'ju treguar si ka punuar Partia Socialiste, sepse besoj që Partia Socialiste ka pasur kohë për t'u provuar të gjithëve që i ka fituar zgjedhjet edhe kur nuk ka pasur asgjë në dorë, edhe kur ka qenë në pushtet. Ka qenë ajo parti që e lëshoi qeverinë në vitin 2017, gjysmën e qeverisë ia dha opozitës dhe ju prapë nuk fituat. I fituam zgjedhjet edhe në 6 mars. Çfarë duhet të themi tani? Në qoftë se ne vërtet e mbështesim reformën në drejtësi, këtë nuk mund ta përdorim si argument dhe ta invokojmë sa herë na intereson. Jo, SPAK-u është duke zhvilluar një hetim për këtë çështje. Të presim, të kemi durim dhe të gjejmë edhe origjinën e shpërndarjes së atyre të dhënave. Faleminderit, zonja Kryetare!